



20

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT**  
**OSNOVNI SUD PRIZREN – BASIC COURT OF PRIZREN**

**P.nr.1542/17**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN** - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Shpresa Emra me sekretaren juridike Birsën Shoshani, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. S. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 28 të KP, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Departamenti i Përgjithshëm në Prizren PP/II nr.1673-3/17 të dt. 20.07.2017 dhe marrëveshjes për pranimin e fajësisë PP/I.nr. 1673-3/17 të dt. 20.07.2017 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik në prezencën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, Prokurori shtetit Musli Gashi, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av.A. M. me datë 30.08.2017 publikisht mori dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari: A. S.** nga i ati F. dhe e ëma N., të vajzërisë L. i lindur më në A. të Gjermanisë, me vendbanim në Prizren në rr. nr. , i pa martuar, i pa punë, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës


**ËSHTË FAJTOR**

Se me datën 28.06.2017 rreth orës 23;00 minuta, në Prizren, në rrugën " ", me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, tenton t ia merre pasurinë e të dëmtuarit S. Th në atë mënyrë që duke kapërcyer pengesat, përmes dritares së banesës së të dëmtuarit, hyn brenda dhe derisa i njëjti kërkonte para në banesë, vjen i dëmtuari dhe me të vërejtur këtë, i pandehuri largohet nga vendi i ngjarjes.

**Me këtë ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1 nënpar. 1.1 lidhur me nenin 28 të KP**

Pranohet marrëveshja për pranimin e fajësisë PP/II.nr. 1673-3/17 të dt. 20.07.2017 e lidhur në mes të Prokurorit të shtetit pranë Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i përgjithshëm dhe të akuzuarit A. S. me mbrojtësin e tij av. A. M.

Andaj, gjykata në kuptim të dispozitave të nenit 7, 8, 9, 10, 41, 42, 43, 46, 73 dhe, 327 par.1 par. 1 nënpar. 1.1 lidhur me nenin 28 të KP të akuzuarit ia shqipton:



## DËNIMIN ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një), viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohor prej 2 (dy) viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale dhe

## DENIMIN ME GJOBË

Në lartësi prej 200 (dyqindë) €, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari S. Sh. Th. nga Prizrenit, rr. nr. për realizimin e kërkesës pronësoro juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil – juridik.

Obligohet i akuzuari që t' i paguaj shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

## Arsyetim

Prokuroria e Shtetit-Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzë PP/II.nr. 1673-3/17 të dt. 20.07.2017 kundër të akuzuarit A. S. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 28 të KP

Prokuroria Themelore në Prizren Departamenti përgjithshëm përkitazi me aktakuzën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 28 të KP me të akuzuarin A. S. dhe mbrojtësit tij av. A. M. kanë hyre në marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Në shqyrtimin e dt.30.08.2017 i mbajtur në këtë çështje penale përkitazi për marrëveshjen e cekur më lart gjykata bazuar në nenin 233 të KPP-ës, ka vlerësuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë e ka dëgjuar të akuzuarin në prezencën e mbrojtësit të tij, dhe ka konstatuar se pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij.

Gjyqtari gjykues konstaton se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara ligjore konform nenit 233 par. 18 i KPP-ës, andaj ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe pas përfundimit të dëgjimit në seancë ka shqiptuar edhe dënimin në suazat e marrëveshjes në mes të palëve.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori në kuptim të nenit 450, 451 dhe 453 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr.1542/17 të dt. 30.08.2017

Sekretare Juridike  
Birsen Shoshani



**UDHËZIM JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.